

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6696
E shtunë, 3 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Lansohet platforma
për shërbime komunale
E-Komunat | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MËSIMDHËNËSIT DHE SHËRBYESIT CIVILË VAZHDOJNË GREVËN,
KËSHILLI GREVIST I BSPK-së TAKON OPOZITËN | FAQE 4-5

RRAHMAN JASHARAJ, OPOZITËS: MOS TË LEJOJMË QË KOSOVA TË KTHEHET NË NJË SHTET DIKTATORIAL



Kryetari i Këshillit Grevist i BSPK-së, Rrahman Jasharaj dhe nënkryetari i këtij këshilli, Ali Gashi, janë takuar të premten me liderët e partive opozitare, nga të cilët kanë kërkuar përkrahjen e partive opozitare për situatën e rëndë në të cilën po kalojnë mësimsdhënësit dhe

shërbyesit civilë. Rrahman Jasharaj ka kërkuar nga opozita që të gjithë të bëhen bashkë dhe të mos lejojnë që Kosova të kthehet në një shtet diktatorial. "Veprimet e tilla kanë tendencë që të shtypen dhe të heshten sindikatat", ka thënë Jasharaj

NË SAMITIN "BALLKANI I HAPUR" I BËHET THIRRJE BE-SË PËR NDIHMË PËR BLERJE TË ENERGJISË | FAQE 3



LIMAJ: ÇDO GJË QË ËSHTË
NDËRTUAR PËR 20 VJET
PO RRËNOHET NGA KURTI | FAQE 5

AKTUALE



BIDENI: IDEOLOGJIA E TRUMPIT
KËRCËNON DEMOKRACINË
AMERIKANE | F. 2

DY DREJTORË NË POLICINË
RAJONALE NË PRISHTINË U
SHKARKUAN PËR SHKAK TË RASTIT
TË 11 VJEÇES | F. 5

MIRATOHET VAKSINIMI ME DOZËN E
KATËRT KUNDËR COVID-19 PËR DISA
KATEGORI | F. 7

EKONOMI



KOSOVA HAPI NEGOCIATAT PËR
TREGTI TË LIRË ME SHTETET
E EFTA-s | F. 8

NIS FESTA E VJELJES SË RRUSHIT
"HARDH FEST 2022" | F. 8

SPORT



SHEFITI: ME PRISHTINËN SYNOJ
TITULLIN DHE EVROPËN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni: Ideologjia e Trumpit kërcënon demokracinë amerikane

WASHINGTON, 2 SHTATOR - Presidenti amerikan Joe Biden ka kritikuar më 1 shtator Donald Trumpin dhe mbështetësit e tij "ekstremistë", duke i cilësuar armiq të demokracisë amerikane. Duke folur në Filadelfi, presidenti amerikan sulmoi të gjithë republikanët që mbështesin ideologjinë e ish-presidentit Trump "Ta bëjmë Amerikën të Shkëlqyeshme Përsëri (MAGA)" dhe u bëri thirrje mbështetësve të tij që ta luftojnë këtë ideologji. "Donald Trump dhe republikanët MAGA paraqesin një ekstremizëm që kërcënon themelet e republikës sonë", ka deklaruar Biden duke folur pranë vendit ku u miratuan mbi dy shekuj më parë Deklarata e Pavarësisë dhe Kushtetuta amerikane. "Ata përqafojnë zemërimin. Ata lulëzojnë në kaos. Ata nuk jetojnë në dritën e së vërtetës, por nën hijen e gënjeshtërisë. Nuk ka vend për dhunë politike në Amerikë. Pikë. Asnjë vend. Kurrë", ka thënë presidenti Biden. Kjo deklaratë ishte referencë ndaj sulmit ndaj Kongresit amerikan vitin e kaluar nga mbështetësit e Trumpit, të cilët refuzonin që të pranonin humbjen e tij në zgjedhjet presidenciale. Duke përmendur sulmin mbarëkombëtar ndaj të drejtave të abortit nga konservatorët e linjës së ashpër dhe frikën se liritë e tjera nga qasja në kontracëpsion e deri te martesat e gjinisë së njëjtë, presidenti amerikan akuzoi se "forcat MAGA" janë "të vendosura që ta kthejnë shtetin prapa". Teksa po luftohet për kontrollin e Kongresit në zgjedhjet e nëntorit, Biden iu drejtua republikanëve



tradicionale që t'i bashkojnë forcat me demokratët dhe të refuzojnë politikën e Trumpit, që ende ka ndikim mbi pjesën më të madhe të Partisë Republikane. Bideni bëri të qartë se demokratët synojnë që zgjedhjet e nëntorit t'i shndërrojnë një referendum për Trumpin, duke thënë se Partia Republike është tërësisht "e dominuar dhe e frikësuar" nga ish-presidenti dhe agjenda e tij MAGA. "Dhe kjo paraqet kërcënim për këtë shtet", tha ai, duke insistuar se demokracia amerikane duhet të mbrohet. "Mbrojeni atë. Ngrihuni për demokracinë", bëri thirrje Biden.

Trumpi është kundërpërgjigjur ndaj akuzave të Bidenit përmes rrjetit të tij social, Truth Social. Ai tha se Biden nuk është i kualifikuar për të qenë president. "Nëse ai nuk dëshiron që ta bëjë Amerikën të Shkëlqyeshme Sërish, që përmes fjalëve, medimeve dhe veprimeve, ai nuk do, atëherë ai nuk duhet të përfaqësojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës", shkroi Trumpi. Fjalimi i Bidenit që u prezantua si fjalim për "betejën për shpirtin e kombit" - kishte për bazë një artikull që ai botoi më 2017 në The Atlantic, pas një proteste vdekjeprurëse të nacionalistëve të

bardhë në Çarlostvill të Virxhinias, ngjarje, që sipas Biden, e shtyri atë të garojë për president. "Ne po jetojmë në një betejë për shpirtin e këtij kombi", kishte shkruar atëbotë Biden. Sipas një sondazhi të publikuar më 1 shtator nga "The Wall Street Journal", nëse zgjedhjet për Kongres do të mbaheshin sot, 47 për qind e votuesve të regjistruar do të votonin për demokratët dhe 44 për qind për republikanët. Në mars, sondazhet treguan se republikanët ishin në pesë pikë në epërsi. Demokratët po shpresojnë të fitojnë zgjedhjet e nëntorit që kanë

të bëjnë me të gjitha mandatat në Dhomën e Përfaqësuesve dhe një të tretën e ulëseve në Senatën amerikan. Tradicionalisht, zgjedhjet e mesmandatit nuk favorizojnë partinë në pushtet. Megjithatë, gjërat janë përmirësuar në favor të Bidenit së fundi, teksa inflacioni ka nisur që të ulët dhe në Kongres janë miratuar një sërë reformash. Ndërkaq, Trump është duke u përballur me një seri hetimesh kriminale. Sondazhet po ashtu tregojnë se ka mbështetje në mesin e amerikanëve për të drejtat e abortit, gjë që mund të dëmtojë republikanët në zgjedhje.

Miliona persona evakuohen në Pakistan për shkak të vërshimeve



ISLAMABAD, 2 SHTATOR - Punëtorët e shpëtimit të mbështetur nga helikopterë ushtarakë dhe anije kanë vazhduar të premtën operacionet për evakuimin e miliona personave nga fshatrat e largëta në jug të Pakistanit, teksa rajoni po bëhet gati për vërshime të tjera. Pothuajse 20 000 metër kubik ujë për sekondë tani po bie në pjesën veriore të shtetit dhe së shpejti shirat dhe vërshimet do të godasin qytetin e madh, Sind, tha Agjencia për Menaxhimin e Fatkeqësive. Sind ishte goditur më së rëndi nga vërshimet që ndodhën në mesin e muajit qershor. "Ne po tentojmë të arrijmë të njerëzit që gjenden në mes të ujit pa ushqim dhe strehim", ka thënë për Dpa-në, Rustam Jamali, punëtor i shpëtimit nga qyteti Sind. Numri i viktimave nga vërshimet në Pakistan ka arritur në 1.208 dhe ky numër pritet të rritet, tha Agjencia për Menaxhimin e Fatkeqësive.

Ekspertët shëndetësorë kanë paralajmëruar për mundësinë e shpërthimit të sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve të tjera në zonat e prekura nga vërshimet. Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se vërshimet kanë dëmtonuar të paktën 888 ndërtesa shëndetësore, duke penguar përgjigjen e shtetit ndaj krizës shëndetësore të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore. Qeveria pakistaneze tha se mbi 33 milionë persona apo 15 për qind e popullsisë prej 220 milionë banorësh janë prekur nga vërshimet që kanë shkatërruar shtëpi, biznese, infrastrukturë, rrugë dhe po ashtu kanë shkatërruar të mbjellat. Disa vlerësime thonë se një e treta e shtetit aktualisht është nën ujë. Kombet e Bashkuara kanë bërë thirrje për 160 milionë dollarë për të ndihmuar për "këtë fatkeqësi të paprecedent klimatike". Ndërkaq, OBSH-ja ka thënë se mbi 6.4 milionë persona kanë nevojë për ndihmë urgjente humanitare.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Nga samiti “Ballkani i hapur” i bëhet thirrje BE-së për ndihmë për blerje të energjisë



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Presidenti serb Aleksandër Vuçiq, më 2 shtator, pas samitit të liderëve të nismës “Ballkani i hapur”, tha se do të kërkojnë ndihmë nga Bashkimi Evropian për blerje të energjisë.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që gjatë këtij dimri dhe krizës energjetike në Ballkanin Perëndimor, të mos e “përsërisë të njëjtën sjellje” sikurse gjatë pandemisë Covid-19. “Ne e mbajmë mend mirë se si në fillim të pandemisë vendet e Ballkanit Perëndimor u detyruan t’i drejtoheshin Kinës, Rusisë, Turqisë... sepse Bashkimi Evropian shikonte vetëm veten”, tha Rama.

Ai njoftoi se liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë (pjesë e nismës “Ballkani i hapur”) do t’i shkruajnë Brukselit dhe se do të ishin “shumë të kënaqur” nëse liderët e tri vendeve të tjera (Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi e Kosovës) do t’u bashkoheshin atyre.

Në hapje të samitit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se ftesa për pjesëmarrje u është dërguar edhe ministrave të Jashtëm të Greqisë dhe Italisë, por të njëjtit nuk kanë mundur të marrin pjesë në takimin e Beogradit. “Shpresoj që do të marrin pjesë në takimin në Tiranë. Është shumë e rëndësishme për ne që nisma të mbledhë rreth vetes jo vetëm shtetet e rajonit, por edhe shtetet e rëndësishme nga zona përreth”, tha Rama.

Samiti në kuadër të “Ballkanit të hapur” mbledhi së bashku zyrtarë nga vendet e asaj nisme si dhe nga Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina,

Hungaria dhe Turqia.

“Ballkani i hapur” është një projekt i përbashkët i Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, i krijuar me idenë e qarkullimit të lirë të mallrave dhe njerëzve ndërmjet shteteve anëtare të nismës.

Presidenti Vuçiq deklaroi se nga ndalimi i eksporteve të produkteve të caktuara nga Serbia do të hiqen vendet e “Ballkanit të hapur”. “Gjithçka që është në dispozicion të Serbisë, do të jetë në dispozicion të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, si dhe anasjelltas”, tha Vuçiq.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, theksoi se mesazhi i samitit është se vendet e “Ballkanit të hapur” solidarizohen në kohë krize. “Dimri i ardhshëm do të jetë i gjatë dhe ndoshta më i vështirë që nga Lufta e Dytë Botërore, si për ne, ashtu edhe për botën. Është më mirë ta mbijetojmë së bashku sesa të ndarë”, tha Kovačevski.

U nënshkruan marrëveshjet për bashkëpunim në energjetikë dhe bujqësi

Vuçiqi, Rama dhe Kovačevski kryesuan bashkërisht samitin “Ballkani i hapur”.

Pas takimit u nënshkruan marrëveshje dy dhe trepalëshe në fushën e bujqësisë, energjisë, kulturës dhe mbrojtjes civile. Kryesuesi i Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Zoran Tegeltija, tha se është mirë kur vendet bashkërisht i zgjidhin problemet dhe se është i trishtuar që Bosnjë-Hercegovina nuk i nënshkroi sot marrëveshjet. “Ju të gjithë e dini se sa letra kemi

shkruar ne nga Bosnjë-Hercegovina për të na furnizuar me gjëra ushqimore. Shpresoj që edhe pse nuk kemi nënshkruar marrëveshje, ju do të vazhdoni të na furnizoni”, tha Tegeltija.

Kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, shprehu pritjen që edhe vendi i tij të jetë pjesë e marrëveshjes së shteteve të “Ballkanit të hapur” për ta ndihmuar njëri-tjetrin në situata krize për furnizimin me ushqim dhe energji.

Ai theksoi se vendet e rajonit duhet ta ndjekin rrugën e bashkëpunimit dhe të qëndrojnë së bashku. “Gjithçka tjetër mund të jetë llogaritje e imët dhe politizim. Falënderoj mikpritësit dhe miqtë e ardhur nga BE-ja dhe të gjithë ambasadorët që janë këtu. Shpresoj se së shpejti do të takohemi në Mal të Zi”, tha Abazović.

Deri më tani, Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina zyrtarisht nuk i janë bashkuar nismës, ndonëse përfaqësuesit e Bosnjës për herë të dytë po marrin pjesë si të ftuar në takimet e kësaj nisme.

“Suksesi i këtij projekti varet shumë në atë se sa ne do ta konsolidojmë paqen dhe stabilitetin në rajon”, tha presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në nisjen e samitit kryesues të të cilit ishin edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski.

Vuçiqi, po ashtu, tha se marrëveshjet e posaçme, në rast se ka ndalesa për eksportet e produkteve të caktuara, do të japin garanci se ndalesat nuk do të aplikohen për shtetet anëtare të “Ballkanit të hapur”. “U bëj thirrje të gjithë aktorëve politikë, si në

Qeveri ashtu edhe në opozitë, që të njohin rëndësinë e këtij projekti. Është shumë e rëndësishme për ne që të krijojmë një grup punues për parandalimin e krizave, pasi që e dimë se një vjeshtë dhe dimër i vështirë po afrohen”, tha Vuçiqi.

Në takimin e 2 shtatorit po marrin pjesë kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, kryetari i Këshillit të Ministrave në Bosnjë-Hercegovinë nga radhët e komunitetit serb, Zoran Tegeltija. Po ashtu, të pranishëm janë edhe kryediplomati i Hungarisë, Peter Szijjarto dhe ai i Turqisë, Mevlut Cavusoglu.

“Pavarësisht faktit se disa ende nuk janë pjesë e ‘Ballkanit të hapur’, shpresoj që ne do të zhvillojmë bashkëpunimin më të suksesshëm të mundshëm”, theksoi presidenti i Serbisë.

Kryeministri maqedonas, Kovačevski, vlerësoi se nisma është “një shtytëse që na shtyn përballë sfidave të dimrit që po vjen”. “Sot është e qartë se Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Serbia kanë ndërmarrë një hap vendimtar në një moment vendimtar. Derisa disa të tjerë mendojnë se kjo mund të na largojë nga rruga evropiane, unë mendoj se kjo do të na forcojë dhe do t’ua lehtësojë jetën qytetarëve”, tha ai në hapje të samitit.

Kovačevski, po ashtu, tha se përmes marrëveshjeve, anëtarët e “Ballkanit të hapur” do të angazhohen që të sigurojnë stabilitet në furnizimin me ushqime. “Ne do ta ndihmojmë njëri-tjetrin në të gjitha sfidat dhe çrregullimet që do të mund t’i hasim në tregjet e produkteve bujqësore”, theksoi ai. Kryetari i Këshillit të Ministrave të

Bosnje e Hercegovinës, Zoran Tegeltija, tha se në samit po merr pjesë si mysafir dhe vlerësoi se, siç i quajti ai, bllokadat në BeH ndonjëherë janë shumë të forta. “Sot këtu do të deklarohet edhe një herë se është e nevojshme që BeH-ja t’i bashkohet ‘Ballkanit të hapur’”, tha Tegeltija dhe i krahasoi ato liri me BE-në.

Ai vlerësoi, gjithashtu, se pranimi i BeH-së në proces është i sigurt.

Shefi i diplomacisë turke, Mevlut Cavusoglu, vlerësoi se nisma “Ballkani i hapur” siguron një të ardhme të sigurt për të gjitha vendet. “Lufta në Evropë është alarm për të gjithë dhe ne po e shohim se sa të pambrojtur jemi në aspektin energjetik. Nuk ekziston ndonjë recetë tjetër përveç solidaritetit dhe ne në Turqi po bëjmë gjithçka që mundemi për të ndihmuar fqinjët tanë në Ballkan që të sigurojnë sasi të gazit”, tha ai.

Cavusoglu theksoi se ka ende shumë për t’u bërë në Ballkanin Perëndimor, por se ekzistojnë dy sfida.

Si pjesë e samitit, në takimin e liderëve do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit që janë përgjegjës për tërheqjen e investimeve brenda kësaj nisme. Po ashtu do të ketë takim të përfaqësuesve të grupeve të krizës, ku do të diskutohet për furnizimet me ushqim dhe energji.

Samiti po mbahet pas hapjes së Panairit të Verërave, që është ngjarje në kuadër të “Ballkanit të hapur”. “Vizioni i Verës për Ballkanin e Hapur” është ngjarje që u hap më 1 shtator dhe në hapje morën pjesë, Vuçiq, Rama, Kovačevski dhe zyrtarë të tjetër të shteteve që iniciuan “Ballkanin e hapur” më 2019.



MËSIMDHËNËSIT DHE SHËRBYESIT CIVILË VAZHDOJNË GREVËN, KËSHILLI GREVIST I BSPK-SË TAKON OPOZITËN

Rrahman Jasharaj, opozitës: Mos të lejojmë që Kosova të kthehet në një shtet diktatorial

Kryetari i Këshillit Grevist i BSPK-së, Rrahman Jasharaj dhe nënkryetari i këtij këshilli, Ali Gashi, janë takuar të premten me liderët e partive opozitare, nga të cilët kanë kërkuar përkrahjen e partive opozitare për situatën e rëndë në të cilën po kalojnë mësimdhënësit dhe shërbyesit civilë. Rrahman Jasharaj ka kërkuar nga opozita që të gjithë të bëhen bashkë dhe të mos lejojnë që Kosova të kthehet në një shtet diktatorial. “Veprimet e tilla kanë tendencë që të shtypen dhe të heshten sindikatat”, ka thënë Jasharaj

e Kosovës, do të iniciojmë mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për të marrë veprime të tjera, të cilat do të mundësojnë kthimin e ligjshmërisë në këtë vend. Le ta dijë Albin Kurti që kurrë nuk ka për të guxuar as nuk ka për t’ju lejuar që ta kthejë Kosovën në diktaturë”, ka theksuar kryetari i PDK-së. Ndërsa Rrahman Jasharaj ka thënë se takimi me liderët e partive

politike parlamentare vjen si rezultat i pamundësisë së dialogut me qeverinë Kurti për 9 muaj radhazi. “Është mirë që të gjithë të bëhemi bashkë dhe të mos lejojmë që Kosova të kthehet në një shtet diktatorial. Veprimet e tilla kanë tendencë që të shtypen dhe të heshten sindikatat. Kur sindikatat janë të shtypura dhe të heshtura, atëherë një shtet nuk mund të jetë demokratik”, ka

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari Këshillit Grevist i BSPK-së, Rrahman Jasharaj dhe nënkryetari i këtij këshilli, Ali Gashi, janë takuar të premten me liderët e opozitës, me të cilët kanë diskutuar për situatën e rëndë në të cilën po kalojnë mësimdhënësit dhe shërbyesit civilë për shkak të vendimit të qeverisë Kurti për mosekzekutim të pagave për muajin gusht.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, duke kritikuar qeverinë për qasje autoritare dhe diktatoriale, ka thënë se kjo sjellje arrogante ndaj mësimdhënësve dhe zyrtarëve publikë është e paparë në historinë e vendit tonë. “Nuk ka ndarje në mes të prindërve dhe mësimdhënësve. Mësimdhënësit janë prindërit tanë. Mësimdhënësit janë prindër, po ashtu. Dyert e shkollave më 1 shtator i ka mbyllur Albin Kurti, nuk i kanë mbyllur mësimdhënësit. Sepse Albin Kurti si kryeministër i ka pasur të gjitha

mundësitë, që duke dialoguar me sindikalistët, të gjejë zgjidhje, të ofrojë mundësi në këtë krizë të jashtëzakonshme ekonomike të cilën po e kalojnë të gjitha familjet e Kosovës”, ka theksuar lideri i PDK-së.

Krasniqi ka thënë se askush nuk ka të drejtë t’i ndalë pagat e sindikalistëve, aq më pak në këtë periudhë kur familjet po përballen me rritje të çmimeve dhe mungesë të energjisë elektrike. “Mosekzekutimi i pagave është vepër penale, është shkelje ligjore. Sot Qeveria e Albin Kurtit me ministrin Hekuran Murati i kanë privuar rreth 45 mijë familje prej pagave të tyre”, shtoi Krasniqi. PDK-ja kërkon nga qeveria që t’i kthehet dialogut të mirëfilltë dhe t’i ftojë sindikalistët për të diskutuar për një marrëveshje, si dhe t’i ekzekutojë pagat e zyrtarëve publikë, mësimdhënësve dhe të gjithë atyre që janë duke u sanksionuar.

Në të kundërtën, Krasniqi ka thënë se PDK-ja do të iniciojë seancë të jashtëzakonshme për të mundësuar kthimin e ligjshmërisë në vend. “Nëse një gjë e tillë nuk

ndodh deri në fillim të javës së ardhshme, ne do ta iniciojmë kthimin e deputetëve në Kuvendin



Dy drejtorë në Policinë Rajonale në Prishtinë u shkarkuan për shkak të rastit të 11 vjeçes



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Dy drejtorë të Policisë Rajonale në Prishtinë janë shkarkuar pas rastit të 11 vjeçes e cila dyshohet se është dhunuar nga pesë persona ditë më parë. Bëhet fjalë për drejtorin e Policisë Rajonale në Prishtinë, Fahredin Verbovci, dhe drejtorin për Operativë Rajonale të Prishtinës, Shkelzen Xhafa, ka bërë me dije të premtën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili ka thënë se nuk mjaftonin dy dorëheqjet, referuar asaj të Samedin Mehmetit nga pozita e drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe Ali Gashit nga pozita e drejtorit për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve. “Në Policinë e Kosovës janë marrë masa e veprime. Janë shkarkuar

zyrtarë të lartë: Drejtori i Policisë Rajonale në Prishtinë dhe drejtori për Operativë në Drejtorinë Rajonale të Prishtinës. E drejtori i përgjithshëm ka ofruar dorëheqje”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Kryeministri ka kërkuar përgjegjësi nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial lidhur me rastin e 11 vjeçes duke thënë se “ku është morali i gjyqtarëve e prokurorëve?”.

11 vjeçja u raportua se ishte dhunuar në Prishtinë nga pesë persona për shtatë orë. Për rastin e saj kanë reaguar qytetarë, aktivistë, figura të njohura e politikanë. Po të mërkurën është mbajtur edhe një protestë masive në Prishtinë.

thënë Jasharaj.

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim kryetarin e Këshillit Grevist të BSPK-së, Rrahman Jasharaj, me qëllim të diskutimit të gjendjes së krijuar si pasojë e grevës së shpallur në të gjitha nivelet në arsim.

Abdixhiku ka dëgjuar kërkesat e tyre si dhe ka shprehur qëndrimin se LDK-ja konsideron që dialogu mes sindikatave dhe qeverisë është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike. Ai ka theksuar se është tepër e nevojshme që palët të dialogojnë në mënyrë që sa më parë nxënësit të kthehen në shkollë, ndërsa mësimdhënësve t'u kthehet dinjiteti.

Abdixhiku ka pohuar se dialogu në këtë fazë është i domosdoshëm sepse ata janë njerëzit e qytetarët tanë dhe penalizimi në këtë krizë të rëndë ekonomike është gjëja e fundit që i duhet këtij vendi. Ai ka theksuar edhe dyshimin për penalizimin e mësimdhënësve gjatë muajit gusht, kur nuk ka pasur pasojë në sistemin arsimor si dhe ka shprehur shqetësimin për dënimin kolektiv ndaj të gjithë mësimdhënësve që është duke u bërë. “Lidhja Demokratike e Kosovës është e përkushtuar t'i dëgjojë të gjitha kërkesat dhe shqetësimet e mësimdhënësve tanë si dhe ta ngrehë zërin në institucionet shtetërore që kjo gjendje e rëndë e krijuar nga paaftësia qeverisëse të tejkalohet sa më parë”, ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i Këshillit Grevist i BSPK-së, Rrahman Jasharaj, dhe nënkryetari i këtij këshilli, Ali Gashi, janë takuar edhe me liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

AKK-ja: Qeveria ta fillojë dialogun me BSPK-në për të dalë nga kjo situatë

Këshilli i Kryetarëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës ka mbajtur takim urgjent në lidhje me situatën e rëndë aktuale sa i përket grevës së

përgjithshme si në sistemin arsimor dhe në atë të shërbimit civil në nivel lokal.

Kryetarët në përfaqësimin e 22 komunave edhe një herë shprehën pakënaqësinë e tyre në lidhje me situatën e krijuar, ku theksuan se një gjë e tillë shkakton pakënaqësi të thella dhe pengesa të vazhdueshme në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. “Kryetarët shprehën angazhimin dhe ndërmarrjen e të gjitha përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, mirëpo kjo gjendje e jashtëzakonshme ka burimin nga mungesa e dialogut të mirëfilltë të qeverisë dhe sindikalistëve. Andaj, Këshilli i Kryetarëve vlerëson se përgjegjësit kryesorë të këtij tensionimi në mes palëve, në këtë rast qeveria dhe BSPK-ja, duhet të dialogojnë në mënyrë që të zhblokohet situata dhe greva të përfundojë, dhe që të gjitha institucionet të kthehen në normalitetin dhe punën e tyre”, ka njoftuar AKK-ja.

Sipas njoftimit, komunat janë ato të cilat po i bartin pasojat e kësaj situatë të rënduar, sikurse është presioni ndaj DKA-ve dhe ZKF-ve, në dorëzimin e listave të zyrtarëve komunalë të cilët janë pjesë e grevës së përgjithshme. Po ashtu, Këshilli i Kryetarëve ka kërkuar që MFT dhe MASHTI të mos ndërhyjnë dhe ta largojnë presionin nga komunat duke kërkuar listat e grevistëve sepse po shkaktojnë diferencimin e individëve e cila shikohet si një tendencë e rrezikshme. “Po ashtu, kryetarët e komunave janë të shqetësuar me ekzekutimin selektiv të pagave për sektorin publik në nivel lokal dhe kjo po shihet si formë presioni dhe ndëshkimi i punonjësve të cilët gjatë kësaj periudhe kanë qenë duke i kryer obligimet e tyre ditore. Në rast se deri me datë 5 shtator 2022 një gjë e tillë nuk realizohet, atëherë komunat janë të detyruara t'i shqyrtojnë mundësitë për marrjen e masave të tjera ligjore për mosekzekutim të pagave nga Ministria e Financave”, ka njoftuar AKK-ja.



Limaj: Çdo gjë që është ndërtnuar për 20 vjet po rrënohet nga Kurti

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vlerësuar se shteti është duke u rrënuar për shkak të vendimeve të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Ai këtë deklaratë e ka dhënë në një konferencë për medie të premtën, duke shtuar se kabineti qeveritar është duke bërë

veprime eksperimentale. “Shteti ka marrë një drejtim të gabuar në shumë skandale. Sfidat po e rëndojnë jetën e qytetarëve dhe rreziku është për t'ia hequr drejtësinë këtij shteti. Kemi nevojë për angazhimin e përbashkët. Aktualisht, shteti i Kosovës po ballafaqohet me sfida të mëdha dhe në këto vite po drejtohet nga

njerëz që, fatkeqësisht, po bëjnë eksperimente në shtetin e tyre. Shteti dita-ditës po rrënohet e çmontohet nga ato që e kemi ndërtnuar për 20 vjet. Nëse e lejojmë këtë, shumë shpejt shteti e nënkupton individin dhe e dini ju çfarë nënkupton kur shteti si funksionon që ka elemente diktatoriale”, ka thënë Limaj.

Hapësirat publike në Prishtinë tani e tutje do të jenë nën vëzhgimin e kamerave

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se është finalizuar marrëveshja me Policinë e Kosovës për sistemin e kamerave në hapësirat publike. “Tash e sa kohë jemi në

bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës për hartimin e marrëveshjes për vendosjen e sistemit të kamerave dhe mënyrën e mirëmbajtjes së rrjetit të kamerave në hapësirat publike të kryeqytetit, marrëveshje e

cila u nënshkrua sot”, ka thënë Rama. Ai ka theksuar se bashkë me Policinë e Kosovës u zotuan se do të koordinojnë aktivitete të përbashkëta për përmirësimin e sigurisë në hapësirat publike të kryeqytetit.




Ministri i Kulturës nis vizitat nëpër komuna



VUSHTRRI, 2 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka filluar serinë e diskutimeve me kryetarët e komunave. Temë kryesore e takimeve janë investimet kapitale në kulturë, sport, rini dhe trashëgimi kulturore. Vizita e parë ishte në Vushtrri, ku u prit në takim nga kryetari Ferit Idrizi. “Përmirësimi i infrastrukturës fizike për sportistët, artistët e të rinjtë tanë është një prej prioritetëve tona, të cilin po e zbatojmë me shumë kujdes dhe po i japim vëmendjen e merituar. Sot e kemi filluar një cikël të takimeve me kryetarët të komunave. Do të sigurohemi që projektet aktuale të kenë dinamikë të shtuar dhe t’i përmbyllim ato që janë në realizim, ndërsa po flasim edhe për projekte të reja për t’i adresuar kërkesat e qytetarëve tanë”, ka thënë ministri Çeku.

Ai ka theksuar se me kryetarin Idrizi diskutuan për Muzeun Etnografik të qytetit. “Për finalizimin e këtij investimi u pajtuam që komisioni i ngritur të hartojë sa më parë një raport të plotë me rekomandime dhe pas kësaj të vazhdohet me pranimin teknik në mënyrë që ky muze të hapet sa më parë për publikun”, është shprehur Çeku, duke shtuar se edhe Ura e Gurit është një monument i trashëgimisë kulturore që ka nevojë për ndërhyrje. “Do të angazhohemi që institucionet profesionale të Ministrisë së Kulturës ta vlerësojnë gjendjen në terren dhe t’i japin rekomandimet e tyre për fazat e ardhshme”, ka deklaruar ministri Çeku. Ai ka shtuar se edhe renovimet dhe funksionalizimi i hapësirave ekzistuese sportive po trajtohen me prioritet.

Për gjashtë ditë policia në Gjilan shqiptoi 1 508 gjoba



GJILAN, 2 SHTATOR - Drejtorja Rajonale Gjilan, Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe Stacionet Policore të DRP Gjilan, gjatë periudhës kohore 26.08.2022 - 01.09.2022 kanë realizuar aktivitete në zonën e përgjegjësisë që mbulon shtatë komuna dhe ka shqiptuar 1 508 gjoba për kundërvajtje të

ndryshme si: mosrespektim i shpejtësisë, tejkalim në vijë të plotë, drejtim i mjetit në ndikimin e alkoolit, drejtim i mjetit pa patent shofer, mosmbajtja e distancës, gjendja jo e rregullt teknike e automjetit, skadimi i afatit të regjistrimit, përdorimi i telefonave mobilë, xhamat e

errët, mospërdorimi i brezit të sigurisë etj. Gjatë kësaj jave nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe Stacionet Policore në vazhden e implementimit të Planeve Operative “Sezoni veror”, “Siguria në trafikun rrugor” dhe projektit “Patrullimi inteligjent” janë

ndërmarrë aktivitete: Hetim i 12 aksidentëve të komunikacionit me dëme materiale; Hetim i 11 aksidentëve të komunikacionit me të lënduar; Konfiskim i 22 patentshoferëve; Shqiptimi i 9 kundërvajtjeve për vozitës të motoçikletave. Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe

Stacionet Policore të DRP Gjilan kanë njoftuar se kanë mbajtur dhe vazhdojnë të mbajnë pika të shumta të kontrollit të automjeteve me qëllim të pranisë sa më të madhe në terren dhe parandalimit të aksidentëve të komunikacionit rrugor, me theks të veçantë të aksidentëve me fatalitet.

Shënohet 76-vjetori i shkollës së parë shqipe në fshatin Açarevë

SKENDERAJ, 2 SHTATOR - Në fshatin Açarevë të komunës së Skenderajt është shënuar 76-vjetori i shkollës së parë shqipe në këtë fshat, ndër të parat në Drenicë, ku Rexhep Sylja kishte dhënë odën e tij në shërbim të

mësimit të gjeneratave të asaj kohe. I pranishëm në këtë shënim ishte drejtori i Arsimit, Kastriot Duraku, i cili u shpreh falënderues për kontributin e Rexhep Sylës, i cili pronën private e kishte lëshuar në

funksion të mësimmxënies dhe mësimsdhënies. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe disa nga nxënësit e parë të viteve 76, të cilët kujtuan kohën e mësimit të gjeneratave të hershme.



Miratohet vaksinimi me dozën e katërt kundër Covid-19 për disa kategori

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka miratuar rekomandimin e komitetit për imunizimin e popullatës me vaksinën kundër Covid-19, sipas të cilit

vendim, lejohet vaksinimi me dozën e katërt për të gjithë personat e grupmoshës mbi 50-vjeçare (të paktën katër muaj pas marrjes së dozës së tretë), personat me sëmundje

kronike dhe imunitet të dobësuar të moshës mbi pesëvjeçare (të paktën katër muaj pas marrjes së dozës së tretë) si dhe për profesionistët shëndetësorë,

pa dallim moshe. Rekomandimet e aprovuara janë mbështetur në organizatat kredibile ndërkombëtare të fushës së shëndetësisë.



Lansohet platforma për shërbime komunale E-Komunat

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Në kuadër të portalit shtetëror është lansuar platforma për shërbime komunale E-Komunat që në këtë fazë përfshinë shërbimet administrative të lëshuara nga autoritetet komunale për qytetarët dhe bizneset. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) që nga viti 2021 ka qenë e angazhuar që të jetësohet programi i saj për digjitalizimin e shërbimeve që ofrojnë komunat dhe aktivitetet e tyre. "Me këtë rast e falënderojmë International Financial Cooperation, agjenci kjo që funksionon në kuadër të Bankës Botërore në Kosovë për mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe digjitalizimin fillimisht të shërbimeve administrative të komunës së

Prizrenit dhe Lipjanit për këtë fazë duke vazhduar me faza të tjera ku do të përfshihen 38 komunat e Republikës së Kosovës", ka njoftuar MAPL.

MAPL, gjithashtu, ka falënderuar edhe Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit për mbështetjen në arritjen e këtij objekti strategjik afatgjatë të ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Platforma E-Komunat është objektivë strategjike e MAPL-së dhe aktivitet në kuadër të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, si dhe parashihet t'i ketë të digjitalizuara të gjitha shërbimet, aktivitetet dhe procedurat komunale.



Tahir Ahmeti: Qeveria po rrezikon mirëqenien e zjarrfikësve



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se zjarrfikësit, krahas punës së rrezikshme profesionale që e bëjnë, ata kanë një profesion krejtësisht human dhe janë gjithmonë në shërbim të sigurisë së qytetarëve

dhe mbrojtjes së pronave të tyre. "Edhe pse me kushte të këqija të punës dhe me paga jo të kënaqshme, ata kryen punën e tyre me dinjitet dhe nder. Qeveria dhe shteti i Kosovës, në vend se t'u dalë në ndihmë zjarrfikësve në këto kohë të vështira ekonomike, merr vendim pa asnjë arsye, që të mos u ekzekutohet paga e fundit, duke

rrezikuar mirëqenien për ta dhe familjet e tyre", ka thënë Ahmeti. Ai ka theksuar se veprimet e tilla me të drejtë shkaktojnë indinjatë dhe revoltë te kjo kategori e të punësuarve. "Nuk guxojmë të rrezikojmë me këtë institucion të rëndësishëm të sigurisë. As nuk duhet të detyrohen zjarrfikësit të hyjnë në grevë", ka thënë Ahmeti.

Nuk i marrin pagat, protestojnë punëtorët shëndetësorë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Para Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të premtën në Prishtinë 15 minuta kanë protestuar punëtorët shëndetësorë si shenjë revolte për mosekzekutimin e pagave. Kryetari i Shoqatës Sindikale të QKMF-së në Prishtinë, Sherif

Makolli, ka thënë se kjo protestë ka ardhur si rezultat i indinjatës së tyre pas mosekzekutimit të pagave. Sherifi ka theksuar se nuk e di arsyen e mospagesave të pagave të tyre ndonëse dje kanë tentuar të marrin përgjigje. Ai ka thënë se punëtorët shëndetësorë nuk kanë qenë në grevë.



67 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë realizuar 486

testime ku janë konfirmuar 67 raste të reja me Covid-19. Në këtë periudhë kohore

nuk është raportuar për asnjë rast të vdekjes. Sipas MSh-së, nga Covid-19 janë shëruar 203 persona,

ndërkaq raste aktive janë 885. Në 24 orët e fundit 17 qytetarë kanë marrë vaksinën kundër Covidit.



Bien çmimet e ushqimeve në tregjet ndërkombëtare

PRISHTINË, 2 SHKURT - Çmimet globale të ushqimeve bien pas rifillimit të transportit të grurit ukrainas. Për të pestin muaj radhazi, çmimet globale të ushqimeve kanë rënë sipas

indeksit të çmimeve të ushqimeve të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë, raporton "skynews". Ai tha se kjo është pjesërisht falë rifillimit të eksporteve nga

portet e Detit të Zi të Ukrainës, të cilat filluan sërish pasi një marrëveshje u ndërmjetësua nga OKB-ja dhe Turqia. Çmimet kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme që nga

marsi, duke rënë me 1.9 për qind në muajin gusht. Rënia u ul, gjithashtu, për "perspektivat e përmirësuar të prodhimit në Amerikën e Veriut dhe Rusi".



Kosova hapi negociatat për tregti të lirë me shtetet e EFTA-s



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Republika e Kosovës dhe shtetet anëtare të EFTA-s (Norvegjia, Zvicra, Islanda dhe Lihtenshtajni) janë takuar në Gjenevë për raundin e parë të negociatave drejt një marrëveshjeje të tregtisë së lirë. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nëpërmjet ekipit negociator të përbërë dhe udhëhequr nga Zef Dedaj, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm në KIESA, Arjeta Shaqiri Latifi, shefe e kabinetit të

ministres Rozeta Hajdari dhe përfaqësues të tjerë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Dogana e Kosovës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë zhvilluar negociatat me delegacionin e EFTA-s të kryesuar nga Karin Buchel, ministre në Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës. Palët negociuese diskutuan mbi tregtinë e mallrave, rregullat e origjinës, lehtësimin e tregtisë, masat sanitare dhe fitosanitare,

barrierat teknike në tregti, konkurrencën, mjetet juridike tregtare, çështjet ligjore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, tregtinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Ndërsa investimet, shërbimet dhe prokurimet qeveritare u trajtuan në nivel të krerëve të delegacioneve dhe u pajtuan që po në këtë nivel të diskutohen përsëri në raundin e dytë të negociatave që do të mbahet në Republikën e Kosovës. Shtetet e EFTA-s mbeten partnerë të rëndësishëm tregtarë

të Republikës së Kosovës. Shkëmbimet tregtare me këto vende kanë shënuar vazhdimisht rritje. Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, në vitin 2019 eksportet e Kosovës ishin 26.28 milionë euro, ndërsa në vitin 2021 eksportet u rritën dukshëm, duke shënuar 52.09 milionë euro. Ndërsa sa iu përket importeve nga shtetet EFTA-s, në vitin 2019 vlera e importeve ishte 33,86 milionë euro, ndërsa në vitin 2021 ishte 35,6 milionë euro, rrjedhimisht një bilanc tregtar pozitiv. Synimi kryesor i kësaj

marrëveshjeje është zgjerimi i mëtejshëm i pranisë së produkteve të Kosovës në tregjet e EFTA-s, krijimi i një ambienti konkurrues, eliminimi i barrierave tregtare me fokus të veçantë rritjen e eksporteve dhe investimeve. Diskutimet ishin konstruktive dhe hapën rrugën për përfundimin e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë reciprokisht të dobishme. Delegacionet u morën vesh për ta mbajtur një raund të dytë të negociatave tregtare në Prishtinë deri në fund të vitit 2022.

Nis festa e vjeljes së rrushit "Hardh Fest 2022"



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Me sloganin "Ca kokrra rrushi" këtë vit ka nisur edicioni i 20 i festës së vjeljes së rrushit - "Hardh Fest, n'Konak të Rahovecit". Ceremonia zyrtare e këtij edicioni u hap me prerjen e kalaveshit të rrushit, ku të pranishëm ishin përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, komuna e Rahovecit, vreshtarë, prodhues të verës, artistë, e qytetarë të shumtë. Liburn Jupolli, këshilltar i ministrit Hajrulla Çeku, ka

theksuar se "Hardh Fest" po e ruan flakën e traditës sonë, po e bën trashëgiminë tonë të gjallë dhe të afërt me publikun dhe po e jep njërin prej shembujve më të mirë të kultivimit dhe zhvillimit të vlerave tona si shoqëri. Ai ka shtuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit qëndron prapa çdo iniciative që i shtyn përpara vlerat tona dhe zhvillon kulturën në çdo nivel. E veçanta e këtij edicioni është pjesëmarrja e legendës së muzikës rock, Kip Winger, ish-

anëtar i grupit Alice Cooper dhe lider i grupit Winger, i nominuar për Grammy Award në kategorinë "Best Contemporary Classical Composition", i cili performon më 3 shtator. "Hardh Fest" 2022 mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Rahovecit dhe mbështetjen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Sivjet "Hardh Fest" vjen me një program të pasur tregtar, me shumë aktivitete dhe do të zgjasë deri më 4 shtator.

Jep dorëheqje Dukagjin Kastrati, kryesues i Bordit të Përkohshëm të Infracos-it

Prishtinë, 2 shtator - Dukagjin Kastrati ka dhënë dorëheqje nga kryesuesi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Infracos"

Sh.A. Lajmin për "Telegraf"-in e ka konfirmuar Kastrati duke thënë se arsyeja e dorëheqjes së tij është angazhimi i tij në zyrën e Unionit Evropian. "Po, kam

dhënë dorëheqje. Arsyeja e dorëheqjes është për shkak të angazhimit këtu në zyrën e Unionit Evropian", ka thënë Kastrati. Bordi i Përkohshëm i

Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Infracos" Sh.A., në krye me Dukagjin Kastratin, ishin emëruar në muajin gusht nga Qeveria e Kosovës.



“Normaliteti” i ri. Do përjetojmë shumë ngjarje që ndodhin një herë në jetë



Nga William HAGUE

Kur dëgjova debatin e parë televiziv për zgjedhjen e kreut të ri të Partisë Konservatore, fraza që më bëri të reflektoja më shumë ishte momenti kur Liz Trus tha se pandemia e Covid-19 ishte një “ngjarje që ndodh një herë në 100 vjet”. Argumenti i saj ishte se kjo ishte një dukuri kaq e rrallë, sa që borxhet e mëdha që shkaktoi mund të mbarten për një periudhë afatgjatë në vend se të kërkojnë rritje të menjëhershme të taksave.

Arsyeja pse kjo deklaratë më bëri të mendohem kaq shumë, është se ne po përjetojmë shumë ngjarje që janë të jashtëzakonshme në raport me përvojën tonë të kohëve të fundit.

Në kushtet e një pandemie globale, inflacioni në nivele shumë të larta, një luftë të madhe, një thatësire të rëndë e të shumë-përhapur, një krize të vazhdueshme të demokracisë amerikane, është e natyrshme të supozohet se secila prej tyre ndodh vetëm një herë në jetën e njeriut, dhe se ne do të rikthehemi në situatën më të qëndrueshme me të cilën ishim mësuar. E megjithatë, për secilën nga këto çështje, ka shumë të ngjarë që ky supozim të jetë i gabuar. Implikimet janë shumë të gjera. Duke kthyer kokën pas, duket e arsyeshme të thuhet se një pandemi si ajo e Covid-19 ndodh vetëm një herë në 100 vjet. Në fakt, Organizata Botërore e Shëndetësisë e tha saktësisht këtë gjë që kur virusi filloi të përhapet, për ta paralajmëruar botën se sa serioz do të ishte ai.

Pandemia e fundit e rëndë ishte Gripi Spanjoll i viteve 1918-1920, një shekull më parë. Por sot bota banohet nga 4 herë më shumë njerëz se sa në vitin 1918. Ata udhëtojnë shumë më tepër, dhe janë shumë më të angazhuar në prerjen e pyjeve, dëmtimin e tokës dhe tregtimin e paligjshëm të kafshëve të egra.

Që të gjitha këto aktivitete e bëjnë shumë më të lehtë kalimin nga kafshët tek njerëzit të sëmundjeve zoonotike. Rastet e Ebolas, Sars, Mers, Zika-s dhe tani lisë së majmunëve, përbëjnë një dëshmi të bollshme se ajo që ishte e vërtetë nëse kthen kokën pas nuk është më e vlefshme nëse shihet përpara.

Edhe nëse bini dakord me pikëpamjen alternative se Covid u arratis nga një laborator, gjërat nuk mbeten më pak shqetësuese. Numri i laboratorëve në botë që trajtojnë patogjenë të avancuar, në nivelin më të lartë të biosigurisë, është rritur nga 40 në 60 vetëm në dekadën e fundit.

Ato merren me kërkime të rëndësishme, por nëse gabimi njerëzor shkakton një pandemi, ne po e zgjerojmë hapësirën për to. Sipas një studimi nga Universiteti i Padovës në Itali, në përgjithësi shkalla në rritje me të cilën patogjenët e rinj po infektjnë njerëzit, do të thotë që probabiliteti i pandemive të reja trefishohet në dekadat e ardhshme.

Prandaj, nuk është më e arsyeshme që një pandemi të konsiderohet si një rrezik që shfaqet një herë në një shekull. Nëse nuk ndryshojmë mënyrat tona të jetesës, pandemia e ardhshme do të shfaqet shumë më shpejt se sa kaq. Por të

paktën, po e qetësoni veten, duke thënë se rritja e madhe e çmimeve të energjisë nuk mund të zgjasë shumë, pasi ajo është shkaktuar nga lufta në Ukrainë, apo jo?

Ju mund të thoni: Sigurisht që lufta s’mund të zgjasë edhe për shumë kohë, dhe inflacioni do të rikthehet pas disa vitesh në nivelin 2 për qind, pasi kështu këmbëngul edhe Banka e Anglisë. Edhe kreu laburist i opozitës britanike, Keir Starmer duket se mendon kështu, pasi javën e kaluar premtoi të ngrijë faturat e energjisë të gjithëve me një kosto astronomike prej 60 miliardë paund në një vit, me mendimin se kjo do të jetë një masë e përkohshme.

Ai mendon qartë se kemi të bëjmë me një problem emergjent, me ndoshta një tjetër ngjarje që shfaqet një herë në një shekull. Në fakt çmimet e energjisë mund të bien ndjeshëm, sidomos gjatë një recesion botëror. Por ato po rriteshin që para luftës në Ukrainë, dhe do të jenë shumë të paqëndrueshme gjatë tranzicionit drejt energjisë së pastër, si rezultat i ruajtjes së pamjaftueshme, infrastrukturës dhe i diversifikimit të furnizimit me lëndë djegëse fosile që i përdorim ende.

Të gjithë mund të shpresojmë që lufta do të përfundojë së shpejti, por në fakt ajo po tregon më shumë shenja zgjerimi – në Krime dhe me shumë gjasa në Bjellorusi – sesa të mbarimit. Sa i përket inflacionit, është e vështirë që efektet e një luftë të zgjatur, ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit global dhe mungesa në rritje e punëtorëve në ekonomitë më të përparuar

të mundësojnë një rikthim së shpejti në normalitet.

Sigurisht, nuk ka pasur kurrë një botë “normale”, ku gjithçka të ketë qenë në rregull. 20 vitet e para të këtij shekulli, sollën sulmet e 11 Shtatorin dhe krizën financiare globale. Por deri para disa vitesh kishte pasur një periudhë të mjaftueshme lirie nga sëmundjet, inflacioni i ulët, rritje ekonomike të kënaqshme si pasojë e globalizimit, paqe midis fuqive të mëdha dhe stabilitet politik në demokraci. Ndërkohë tani duhet të mësohemi me idenë se normaliteti nuk do të rikthehet. Mendoni pak për çështjen e klimës: Lumi Rin në Gjermani thahej gati tërësisht një herë në 20 vjet. Por ndodhi në vitin 2018, dhe u përsërit këtë verë. Në nivel global, 9 nga 10 vitet më të nxehta të regjistruara kanë ndodhur 10 vitet e fundit. Dhe ky nuk është një rast i vetëm: klima jonë normale nuk ekziston më.

Ose mendoni për demokracinë: një president amerikan u përpoq të përmbyste një rezultat zgjedhor legjitim, dhe partia e tij e mbështet ende. Nuk ka pasur asgjë kaq të rëndë në SHBA që nga Lufta Civile. Pra a është kjo një ngjarje që ndodh një herë në shekull? Mjerisht, ndoshta jo.

Ju mund të thoni: Oh mjaft Uilliam, ju jeni më shumë pesimist nga sa duhet. Sigurisht, që ne duhet të jemi optimistë për të ardhmen. Po edhe këtu na vjen në ndihmë historia. Kur gjyshi im lindi në vitin 1901, do të ishte krejtësisht e saktë të isha optimist për gjendjen në të cilën do të ishte bota kur ai të vdiste në vitin 1998.

Sepse ai pa sesi shekulli XX-të solli një përmirësim të madh të gjendjes se njerëzimit, sido që ta matni atë: jetëgjatësia, shëndeti, higjiena, paqja, liria dhe prosperiteti. Por ai përjetoj gjithashtu kataklizmat e dy luftërave botërore, dhe konceptet e vjetra të asaj që ishte normale humbën njëherë e përgjithmonë.

Ne ende mund të shpresojmë që ky shekull do të jetë më i mirë sesa kaq. Mjafton të vizitosh një shkollë për t’u ndjerë optimist: në vitin 2100 do të kemi mësuar të jetojmë në ekuilibër më të mirë me natyrën, me një strukturë të re të marrëdhënieve paqësore ndërkombëtare dhe duke përdorur ilaçe dhe teknologji të reja të jashtëzakonshme.

Por harku i historisë është në fakt një vijë kaotike, me kulme të mprehta në të cilat supozimet duhet të ndryshojnë, dhe kur optimisti duhet të jetë realist. Tani ndodhemi pikërisht në një nga ato kulme. Dhe kjo ka pasojë për të gjithë. Personi që doli në pension herët në ambiente të caktuara, mund të dëshirojë të mendojë të kthehet në punë.

Kompania që i importon të gjithë lëndën e parë nga një vend, ose nëpërmjet një porti apo poshtë një lumi, duhet të diversifikojë mënyrën e furnizimit. Qeveria e ardhshme, e Trus, Sunak, Starmer apo kujtdo tjetër, duhet të ndihmojë ata që do të vuajnë, ndërsa t’i ndihmojë të tjerët të përshatën me fundin e asaj që deri sot e cilësonim si normale. Duke pasur parasysh sesa ngjarje ndodhin një herë në 100 vjet, ne jemi gati të përjetojmë shumë prej tyre.

“The Times” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Shefiti: Me Prishtinën synoj titullin dhe Evropën

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Skuadra e Prishtinës nuk e ka mbyllur "kuletën" sa iu përket transfereve cilësore në afatin kalimtar të verës. Një nga dëshirat e kësaj vere të trajnerit Ismet Munishi ka qenë edhe sulmuesi i krahut, Shefiti Shefiti. 24-vjeçari shqiptar nga Tetova e Maqedonisë së Veriut vjen te Prishtina nga skuadra shqiptare Renova e Xhepçishtit, klub i cili është shuar për shkaqe financiare. Shefiti ka luajtur me shumë sukses te Renova duke marrë pjesë me këtë ekip edhe në garat evropiane. Para Renovës, Shefiti ishte pjesë e Shkëndijës së Tetovës për katër edicione derisa i ka fituar edhe dy tituj kampion dhe një Kupë të Maqedonisë së Veriut. Shefiti konsiderohet futbollist me potencial dhe vlerat e tij kanë rënë në sy edhe të drejtuesve të Federatës Shqiptare të Futbollit ku vite më parë ka qenë e kombëtares "kuqezi" (U-21). Pas testeve mjekësore të kryera me sukses, nënshkrimi të kontratës njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër me Prishtinën, Shefiti është njohur me ambientet e stadiumit 'Fadil Vokrri' dhe është prezantuar edhe me futbollistët e më pas i ka filluar stërvitjet derisa e ka dhënë edhe një intervistë për faqen zyrtare të klubit bardhekaltër duke u shprehur i lumtur që është bërë "bardhekaltër". "Prishtinës iu bashkova me shumë dëshirë dhe e kam gjetur një kolektiv shumë të mirë. Besoj shumë se do të kemi



suksese drejt qëllimeve që i ka klubi. Është kënaqësi dhe nder ta bartësh fanellën e klubit më të madh në Kosovë. Kjo fanellë duhet mbrojtur me sukses andaj duhet dhënë maksimumin", ka thënë Shefiti. "Synimet me Prishtinën janë titulli

kampion dhe pjesëmarrja në garat evropiane", ka shtuar ai. Shefiti foli edhe për tifozët e Prishtinës, "Plisat": "Plisat' janë tifozët më të mirë në Kosovë andaj ju premtoj më të mirën time për këtë fanellë që kryeqytetin ta nderojmë me suksese".

Drejtuesit e KOK-ut pritën volejbollistin më të mirë shqiptar, Gazmend Husaj

Prishtinë, 2 shtator - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur volejbollistin më të mirë shqiptar, Gazmend Husaj dhe kryetarin e Federatës së Volejbollit të Kosovës, Bahri Gjinovci. Husaj prej vitesh bën karrierë të suksesshme jashtë vendit, kurse ditë më parë është transferuar në klubin Kuvajt të shtetit të Kuvajtit. Ai më parë ka fituar trofe të shumta me klube nga Franca, Turqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe, së fundi, në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku fitoi ligën me Shabab Al Ahli. Husaj ka qenë edhe kapiten i Kombëtares së Shqipërisë, ndërsa muaj më parë vendosi t'i kthehet Përfaqësueses së Kosovës. Presidenti Krasniqi e ka përgëzuar Husajn për karrierën e begatshme, duke theksuar



se ai është inspirim edhe për gjeneratat e reja se si me punë mund të arrihen suksese të mëdha. Presidenti i uroi fat dhe suksese edhe në klubin e ri, po ashtu edhe në kombëtaren tonë, duke vlerësuar ardhjen e tij përforcim të madh. Nga ana e tij, volejbollisti Husaj falënderoi

presidentin Krasniqi për pritjen dhe përkrahjen që po i jep zhvillimit të sportit tonë, në veçanti sportit të volejbollit. Ai theksoi se do të vazhdojë ta përfaqësojë Kosovën në mënyrën më të mirë të mundshme, me besimin se sukseset nuk do të mungojnë edhe me Kosovën.

SHKURT

Reimsi huazon Berishën te Melbourne City

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës, Valon Berisha, është transferuar në Melbourne City. Ai është ndarë me Stade Reimsin për të bërë një aventurë të re në kontinentin e Azisë. Skuadra franceze ka vendosur ta huazojë reprezentuesin "dardan" në Australi te Melbourne City për një edicion. Lajmi është konfirmuar edhe nga presidenti i Reimsit, Jean-Pierre Caillot.

Balaj largohet nga Aarau, kalon te Deince

Liridon Balaj është larguar nga skuadra zvicerane Aarau. Sulmuesi nga Kosova qëndroi në Zvicër për tri vjet ku iu bashkua Aaraus nga Besa e Pejës. Tani ai ka bërë një hap tjetër në karrierë, duke u transferuar në Belgjikë te skuadra Deince. Deince bën gara në kategorinë e dytë të futbollit belg dhe synon të rikthehet në elitë. Balaj me klubin belg ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me opsion vazhdimi edhe për një vit tjetër. Te klubi belg i kanë uruar mirëseardhje Balajt i cili pritet të debutojë në fundjavë me klubin e ri.

Ademi takohet me ambasadorin e ri suedez Jonas Westerlund

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, është takuar me ambasadorin e ri të Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund. Kreu i FFK-së fillimisht i shprehu mirëseardhje ambasadorit suedez në Kosovë teksa e informoi mbi rrjedhën e futbollit dhe projektet që janë duke u realizuar. Ademi u shpreh i lumtur që ambasadori suedez është i afërt me futbollin, duke pasur parasysh se është një ish-futbollist dhe tani një fans i madh i futbollit. Në këtë takim u diskutua edhe për raportet shumë të mira që FFK-ja ka me Federatën Suedeze të Futbollit si dhe për vazhdimin e projekteve të përbashkëta me Ambasadën Suedeze, me synimin që futbollit të ketë shtrirje sa më të gjerë në të gjithë vendin dhe te të gjitha grupmoshat dhe komunitetet.

Kosova U18 mbyll fazën e grupeve në Kampionatin Evropian të Volejbollit në Rërë

Ekipet kosovare U18, femra, i kanë dhënë fund një përvoje të rëndësishme në fazën e grupeve të Kampionatit Evropian të Volejbollit në Rërë, i cili po zhvillohet në Lutraki të Greqisë. Ekipi i femrave, i përbërë nga dyshja Megi Bislimi/Rrezelindë Thaqi, tregoi paraqitje solide në ndeshjen e tretë kundër çiftit grek Kateri/kontakti, pavarësisht disfatës 2-0 në sete. Vashat nga Kosova, të drejtuara nga trajneri Lorik Ilazi, në dy takimet e tjera në kuadër të Grupit B patën punë të vështirë kundër rivalëve shumë të fortë si Ukraina dhe Rumania, nga të cilat pësuan disfata me rezultat të njëjtë (2-0).

Quni fiton përballjen me shqiptarët e shumtë të Kreuzlingenit

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Shumë hendbollistë të Kosovës ishin pjesë e ndeshjes në mes të Amicitia Zuerich dhe HSC Kreuzlingen, që u luajt të enjten në mbrëmje. Për Kreuzlingenin ishte ndeshja e parë në Superligën e Zvicrës në

hendboll. Ndeshjen me rezultatin 33:24 e fitoi Amicitia. Kapiteni i kësaj skuadre është pívoti i Kosovës, Luigi Quni. Ai shënoi pesë gola nga gjashtë tentime. Për Kreuzlingenin luajnë Valon Dedaj, Bujar Ramosaj, Drilon Tahirukaj, Haris

Berisha, Drenit Tahirukaj dhe Lionel Mirdita. Vetëm Mirdita nuk është ende reprezentues i Kosovës. Drenit Tahirukaj shënoi katër gola nga tetë tentime. Lionel Mirdita kishte pesë gola nga 12 tentime. Bujar Ramosaj e Drilon Tahirukaj e realizuan nga

një gol, kurse kapiteni i Kosovës, Dedaj, nuk shënoi në këtë takim. Portieri Haris Berisha i kishte shtatë pritje (7/30). Amicitia Zuerich është prej skuadrave më të forta në Zvicër, ndërsa Kreuzlingenit i duhet të kërkojë pikë në ndeshjet e tjera.



Paul Pogba akuzohet nga vëllai se ka punësuar dikë për t'i bërë magji Mbappes

Paris, 2 shtator - Telenovela e Paul Pogbas vazhdon të marrë vrull. Pak ditë më parë, Mathias, vëllai i lojtarit të Juventusit, akuzoi Paulin se kishte punësuar një mësues fetar mysliman në përpjekje për t'i bërë magji Kylian Mbappe. Kjo akuzë pa dyshim krijoi tituj dhe vetë Mbappe është i hutuar dhe i prirë për një përgjigje. Ylli i PSG-së nuk ka bërë një deklaratë publike, por mediet franceze raportojnë se ai e ka bërë këtë gjë privatisht. "RTL" dhe "M6" raportojnë se Mbappe është interesuar për historinë dhe ka kontaktuar vëllezërit Pogba për ta marrë anën e tyre të historisë. Mbappe dhe ekipi i tij ligjor janë në pritje për të parë se si do të zhvillohet çështja nga distanca, pasi nuk duan të përfshihen ndërkohë që policia bën punën e saj. Ajo që duket qartë është se drama vjen në një



moment të keq për kombëtaren franceze. Me më pak se tre muaj deri në fillimin e Kupës së Botës, nuk duket se dy nga yjet e Francës janë në kushte veçanërisht të mira. Është një situatë që nuk është e re për francezët, pas skandalit të Karim Benzemas dhe Mathieu

Valbuenas të vitit 2015. Trajneri Didier Deschamps do ta emërojë skuadrën e tij në Ligën e Kombeve brenda dy javësh, por ribashkimi mes Pogbas dhe Mbappes nuk do të ndodhë, pasi mesfushori i Juventusit është ende duke u rikuperuar nga një dëmtim në gjurin e djathtë.

Kampioni i botës rikthehet në pistë 3 muaj pas operacionit në shpatull



Madrid, 2 shtator - Sërish në motor. 94 ditë nga operacioni i katërt në shpatull, piloti spanjoll i Hondas, Marc Marquez, do të zbresë sërish në pistë javën e ardhshme. Ai do të marrë pjesë në testet që MotoGP do ta kryejë javën e ardhshme në pistën italiane të Misano. Natyrisht që testet nuk janë një garë, por lajmi i rikthimit në pistë është i

rëndësishëm për një nga ikonat e motoçiklizmit, ku numëron 8 tituj kampionë bote. Është vetë Marquezi ai që ka komunikuar lajmin përmes rrjeteve sociale. Madje spanjollit ka marrë pjesë në disa teste në MotorLand të Aragon, por nuk dihet se çfarë kohësh dha ai apo sa xhiro ka zhvilluar. Për momentin rëndësi ka ndjesia e pilotit me pistën.

"Jam i lumtur që rikthehem në pistë. Ka qenë një periudhë e vështirë, me shumë sakrificë. Faleminderit për mbështetjen!", ka thënë Marquezi. Edhe për Hondan ky është një lajm i mirë, pasi rikthehet në pistë piloti i saj më i mirë. Objektivi është testimi i motorit të vitit 2023 dhe të shihet nga afër gjendja e pilotit me një motor gare.

SHKURT

Vdes ish-boksieri Earnie Shavers

Earnie Shavers, një nga boksierët më të fortë në historinë e boksit, është ndarë nga jeta në moshën 78-vjeçare për shkaqe që ende nuk janë bërë të qarta. Gjatë gjithë karrierës së tij të suksesshme, "The Acorn" Shavers, i njohur gjithashtu si "The Black Destroyer", arriti një rekord prej 74 fitoresh, 14 humbje dhe një barazim (68 nga 74 sukseset e arritura ishin me "Nkockout". "Vetëm Zotë godet më fort se unë" do të deklaronte Shavers në një intervistë. Në vitin 1977 Earnie Shavers humbi përballë Muhammad Aliut në Madison Square Garden në një ndeshje që do të hynte në historinë e boksit. U deshën plot 15 runde, ku gjyqtarët vendosën me vendim anonim.

Aubameyang: Puna ime në Premierë Ligë nuk ka përfunduar ende

Pierre-Emerick Aubameyang është rikthyer në Premierë Ligë, por kësaj radhe do të dërsitet fanellën e Chelseat. "Jam vërtet i lumtur. Është nder të jem pjesë e këtij ekipi dhe mezi pres të filloj. Puna ime në Premierë Ligë nuk ka përfunduar ende, prandaj është shumë mirë të kthehem. Jam i emocionuar", ka thënë Aubameyang. Sulmuesi gabonez u largua nga Arsenali për t'u transferuar te Barcelona, por përvoja e tij në Spanjë ishte shumë e shkurtër, ku regjistroi 24 ndeshje dhe shënoi 13 gola.

Ronaldo qëndron në 'Old Trafford' të paktën deri në janar

"Telenovela" për të ardhmen e Cristiano Ronaldos ka përfunduar me mbylljen e merkatos në pjesën më të madhe të kampionateve me 37-vjeçarin që pavarësisht që kishte shprehur dëshirën për t'u larguar nga Manchester Unitedi, portugezi do të qëndrojë në "Old Trafford". Sipas "The Sun", për shkak edhe të pagës së tij të lartë, asnjë skuadër nuk merrte përsipër transferimin e CR7-s, pasi ekipet që luanin në Ligën e Kampionëve nuk paguanin dot për të. Në këto kushte kapiteni i Portugalisë do të qëndrojë në "Teatrin e Ëndrrave" të paktën deri në janar. Tashmë ish-lojtarit të Real Madridit do t'i duhet ta bindë trajnerin Erik ten Hag që t'i fillojë ndeshjet si titullar, pasi në takimet e fundit që Unitedi ka zhvilluar në Premierë Ligë i ka nisur nga stoli.

Szczesny mungon dy javë

Juventus mund të marrë frymë lirisht, sepse dëmtimi i Wojciech Szczesny nuk është aq serioz sa ishte parashikuar. Është përjashtuar fraktura apo dëmtime në kavilie për portierin e bardhezinjve, që pësoi një dëmtim kundër Spezias dhe vuri në alarm drejtuesit e Juventusit, që për shkak të dëmtimeve janë të detyruar të bëjnë pa shumë lojtarë të rëndësishëm në këtë fillim të kampionatit. Szczesny do të mungojë me siguri për të paktën dy javë dhe nuk do të jetë në fushë në ndeshjet e radhës kundër Fiorentinës në kampionat dhe PSG-së në Ligën e Kampionëve.

Fury do të përballet me Usykn

Tashmë duket punë e kryer dhe adhuruesit e boksit do ta kenë rastin të shohin një tjetër meç të madh. Boksieri

ukrainas Oleksandr Usyk do të boksojë me Tyson Fury. Menjëherë pasi Usyk mbrojtiti titujt e tij të botës kundër

Anthony Joshuas, Fury shkroi në rrjetet sociale për ta thirrur kampionin. Fury i ka dhënë skuadrës së tij një afat deri më

1 shtator për ta bërë luftën dhe tha se nuk do të tërhiqet në ring për asgjë më pak se 500 milionë funte.

Pavarësisht prej këtyre pengesave, Egis Klimas është i bindur se lufta do të realizohet.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Asfaltues - 6 (gjashtë) pozita
Nr. i referencës: NPB/DIU/ 09.13

I raporton: Kryepunëtorit të terrenit - asfaltues

Niveli i pagës: 7

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga Kryepunëtori i Grupit dhe Udhëheqësi i Divizionit që kanë të bëjnë me Divizionin për Intervenime Rrugore (më tutje DIRR);
- Koordinon punët me punëtorët tjerë së bashku me Kryepunëtorin e Grupit në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me DIU-në;
- Bashkëpunon ngushtë me Kryepunëtorin e Grupit për përbushjen e objektivave të DIU-së;
- Merr pjesë në mbledhjet e rregullta bashkë me kryepunëtorin e grupit dhe anëtarët e tjerë të grupit;

Detyrat Specifike:

- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Urgjente në operimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore që kërkohen nga udhëheqësi i Divizionit;
- Është përgjegjës për të gjitha punimet të cilat i kryen grupi;
- Është përgjegjës për mbarevajtjen e të gjithë procesit të punës së grupit;
- Bën evidentime dhe gropave në rrugë dhe trotuare, prerjen dhe pastrimin e gropave, spërkatjen me emulsion të gropave, mbushjen me asfalt, ngjeshjen e asfaltit, rrafshimin e rrugëve dhe trotuarëve me zhavor, shtrimin e kubëzave, pllakave, vendosjen e anësoreve prej betonit, shenjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve, mirëmbajtjen e shenjave të komunikimit etj.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB për punët të cilat i kryen;
- Raporton për punët e kryera të kryepunëtorit i grupit dhe udhëheqësi i njësisë.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Udhëheqësi i Divizionit mund t'a ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së NPB;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund t'i zëvendësojë dhe të kryej detyrat tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që ndërlihen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga menaxhmenti.

Kualifikimet:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Bartësi i vendit të punës duhet të dëshmojë së paku 2 vjet përvojë pune në lëminë e punëve ndërtimore dhe së paku 1 vit punë në punë të asfaltit;
- Patent shofer kategoria-B.

Aftësitë:

- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me punë në asfaltim;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për siguri në punë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Të jetë i gatshëm të punojë natën dhe fundjavave;
- Të jetë i gatshëm të punojë në të gjitha kushtet atmosferike;
- Të jetë i gatshëm të qëndrojë në këmbë për periudha të gjata kohore;
- Aftësi të punojë në ekip, të ketë vetëiniciativë dhe qasje konstruktive;
- Shkathësi të shkëlqyer komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera gjatë karrierës profesionale;
- Preferohet diploma e shkollës së mesme profesionale në ndërtimtar;
- Patentshofer në kategoritë tjera relevante për mjete transportuese dhe mjete të rënda të punës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë të Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- CV/Resume;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Patent shofer kategoria-B;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 2 vjet përvojë pune në punët ndërtimore dhe 1 vit punë në punë të asfaltit;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 02.09.2022 deri më 16.09.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Kryepunëtor/e i/e Terenit-Asfaltues - 1 (një) pozitë
Nr. i referencës: NPB/DIU/ 9.6

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Intervenimeve rrugore

Niveli i pagës: 6

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga Udhëheqësi i Divizionit që kanë të bëjnë me Divizionin për Intervenime Rrugore (më tutje DIRR);
- Ndihmon Udhëheqësin e Divizionit bashkë me Kryepunëtorët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave për Departamentin e Intervenimeve Urgjente;
- Koordinon punët në mes grupeve së bashku me kryepunëtorët e tjerë në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me DIU-në;
- Merr pjesë në mbledhjet e rregullta bashkë me kryepunëtorët e grupeve tjera e cila është në kuader të divizionit;

Detyrat specifike:

- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Urgjente në operimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore që kërkohen nga udhëheqësi i Divizionit;
- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Urgjente në operimin e aktiviteteve të ndërtimit të ulët dhe enterierit dhe aktivitetet operative që kërkohen nga Udhëheqësi i njësisë për investime si dhe Udhëheqësi i Divizionit;
- Është përgjegjës për të gjitha punët të cilat i kryen grupi;
- Është përgjegjës për mbarevajtjen e të gjithë procesit të punës së grupit;
- Bën: përgatitjen e llaçit, muratimi i mureve me materiale dhe dimensione të ndryshme, muratimi i mureve ndarëse, punimi i themeleve, punimi i armaturës, betonimi, kryerja e punimeve suvatuese, ndërtimi i kulmeve, punimi i dyshemeve me produkte të betonit, mbulimi i kulmeve, shtruarja dhe veshja me pllaka, kryerja e punimeve izoluese;
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB për punët të cilat i kryen;
- Të jetë i gatshëm të punojë në ambiente të hapura dhe të mbyllura;
- Të jetë i gatshëm të punojë në temperatura dhe mot të ndryshueshëm;
- Të jetë i gatshëm të punojë në turne të ndryshme, me orar të zgjatur kur nevojitet;
- Të jetë i gatshëm të punojë nën presionin që sjell puna në qytet, ku përfshihen: puna në rrugë me trafik të ngarkuar, puna në rrugë të ngarkuara me kalimtarë, puna me komunitetet dhe kategori të ndryshme shoqërore;
- Raporton për punët e kryera të udhëheqësi i Divizionit për Intervenime;
- Propozon emërimet në pozita adekuate për punonjësit e grupit në bazë të performancës tek udhëheqësi i divizionit;
- Është përgjegjës për performimin e stafit, bën vlerësimin e secilit të punësuar në grupin që Mbikëqyr në baza mujore, gjashtë mujore dhe vjetore;
- Siguron që niveli i punonjësëve, pajisjet dhe sistemet janë adekuate për përbushjen e funksioneve të DIU-së.
- Mbikëqyr punëtorët e grupit në përbushjen e objektivave të bazuara në planin operacional dhe planin e punës;
- Propozon masa disiplinore ndaj punonjësve që kanë performancë të dobët në përbushjen e detyrave të punës tek Udhëheqësi i Divizionit;
- Kontrollon punët dhe mban mbledhje me stafin përgjegjës për punët e kryera ose për pengesat në punë në grupin që Mbikëqyr;
- Përgatit raportet e punës në baza ditore, javore, mujore, vjetore për grupin.

Kualifikimet

- Diplomë e shkolles së mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 2 vite në organizimin e grupeve të ndërtimit;
- Patent shofer kategoria-B;

Aftësitë:

- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me punë ndërtimore;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
- Duhet të jetë në gjendje të lexojë, kuptojë manualët që kanë të bëjnë me makinat dhe procesin e ndërtimit;
- Të jetë i gatshëm të punojë në objekte me lartësi të madhe;
- Të jetë në gjendje të bëjë paramasat dhe parallogaritë për investimet ndërtimore;
- Të jetë i gatshëm të punojë në të gjitha kushtet atmosferike;
- Të jetë i gatshëm të punojë natën dhe fundjavave;
- Të jetë i gatshëm të qëndrojë në këmbë për periudha të gjata kohore;
- Aftësi të punojë në ekip, të ketë vetëiniciativë dhe qasje konstruktive;
- Shkathësi të shkëlqyer komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera gjatë karrierës profesionale.
- Patent shofer në kategoritë tjera relevante për mjete transportuese dhe mjete të rënda të punës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë të Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- CV/Resume;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 2 vite në organizimin e grupeve të ndërtimit;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Patent shofer kategoria-B;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 02.09.2022 deri më 16.09.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 11-22

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtari të profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Institutit A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për furnizim me material shpenzues për zyrat e OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.




Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **16.09.2022 ora 14:00.**


Afati i fundit për aplikim në Tender është: **19.09.2022 ora 12:00.**


Hapja e ofertave bëhet me datën: **19.09.2022 ora 14:00.**


Lume's Details


Estetik & Depilim

 **044 900 978 | 045 681 898**

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Qullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156



+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Erleta Haxhija shpall të humbur ID-kartelën e Kolegjit AAB-Prishtinë, drejtimi Marketing dhe Menaxhim Biznesi-Master.
- ▶ Besim Shabanaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Mjekësisë "HysniZajmi" Teknik – Laborant.
- ▶ Arti Danqeli nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës SH.M.E "Kadri Kusari".
- ▶ Atmire Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " 17 Shkurti " Atmaxhe.
- ▶ Resmi Neziri shpall të pavlefshme 3 dëftesat shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Hadi Susuri shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Mustafa Baku " Prizren.
- ▶ Alida Kalaveshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Rroni Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, dhe certifikatën e maturës e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Floriana Domgjoni nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "At Gjergj Fishta" Bishtazhin, KK Gjakovë. Nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Aldi Cërmjani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII të gjimnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Lumturie Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Blerim Sylaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Erëza Vokshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e e kl.I, II, III, IV e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ "Ideade" Sh.P.K, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810070681.
- ▶ "Natyra" Sh.P.K, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548729.
- ▶ "A&A Coatings" Sh.P.K, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548216.
- ▶ "Lami Project", shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr: 330172388.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues